

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-26-2912-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me buqeta lulesh natyrale, shtiza për flamuj dhe flamuj të ndryshëm për nevojat e Komunës së Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K.
NUI	810611998
Adresa	Rr. Tirana
Vendi	PRIZREN
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	+38349573573
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Hasan Gigollaj
Adresa elektronike	office@alteramall.com
Data e parashtrimit të ankesës	09.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me buqeta lulesh natyrale, shtiza për flamuj dhe flamuj të ndryshëm për nevojat e Komunës së Prizrenit

Njoftimi për kontratë 30.04.2026

Njoftimi për dhënie të kontratës 25.06.2026

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 21.05.2026

Data dhe ora e fillimit të hapjes së ofertave 21.05.2026, ora 14:00

Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Te gjitha njoftimet janë publikuar në platformën e-prokurimi.rks-gov.net

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne si operator ekonomik kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke kundërshtuar vendimin për dhënien e kontratës. Në kërkesën për rishqyrtim kemi cekur se Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar vlerësimin në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, pasi nuk ka marrë në konsideratë kërkesën e detyrueshme për dorëzimin dhe vlerësimin e mostrave, duke cenuar parimet e barazisë në trajtim, transparencës dhe ligjshmërisë. Me vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar, andaj

ne i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për mbrojtjen e të drejtave tona.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim, Jodiskriminimi dhe Transparenca

Neni 27 - Dosja e tenderit

Neni 28 - Specifikacionet Teknike

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për dhenie të kontratës

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kjo ankesë paraqitet kundër:

* Vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;

* Vendimit për tenderuesin e suksesshem Sfinga Sh.P.K.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto Nene të LPP-së:

Neni 1 - Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar procedurën në mënyrë që të sigurojë përdorimin e drejtë, transparent dhe të barabartë të procedurës së prokurimit, pasi ka vendosur një kërkesë në dokumentacionin e tenderit për dorëzimin e mostrave dhe më pas e ka injoruar plotësisht gjatë vlerësimit.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Vendosja e një kërkesë për dorëzimin e mostrave, e cila më pas nuk është marrë fare në

konsideratë, ka krijuar kosto të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe nuk i ka shërbyer zhvillimit efikas të procedurës.

Neni 7 - Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca

Ne kemi respektuar kërkesën për dorëzimin e mostrave, ndërsa operatorët që nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë janë trajtuar njësoj. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsytim se si është zbatuar kjo kërkesë gjatë procesit të vlerësimit.

Neni 28 - Specifikimet Teknike

Autoriteti Kontraktues ka përfshirë në dokumentacion një kërkesë teknike për dorëzimin e mostrave, por nuk e ka zbatuar atë gjatë vlerësimit të ofertave, duke krijuar paqartësi mbi përmbajtjen dhe efektin juridik të dokumentacionit të tenderit.

Neni 56 - Përgjegjshmëria e Tenderëve

Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar në mënyrë të njëjtë përmbushjen e kërkesave të dokumentacionit nga të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk ka analizuar përmbushjen e kërkesës për dorëzimin e mostrave.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje me dokumentacionin e tenderit, pasi nuk ekziston asnjë analizë, procesverbal apo arsytim lidhur me dorëzimin dhe vlerësimin e mostrave, megjithëse kjo kërkesë ishte e përfshirë në paramasë.

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe konsistente kriteret dhe kërkesat që vetë i ka publikuar në dokumentacionin e tenderit para dhënies së kontratës.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues shkon në kontradiktë të drejtpërdrejtë me dokumentacionin e tenderit.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues deklaron se:

"Në asnjë dispozitë të Njoftimit për Kontratë, në Dosjen e Tenderit dhe në Specifikimin Teknik nuk është paraparë obligimi për dorëzimin e mostrave."

Ky konstatim është faktikisht i pasaktë.

Në Paramasë, e cila është pjesë integrale e dokumentacionit të tenderit, ekziston qartë kërkesa:

"Para hapjes së ofertave të sillen mostrat e flamujve."

Prandaj Autoriteti Kontraktues nuk mund të pretendojë se një kërkesë e publikuar nuk ekziston.

Në momentin kur Autoriteti Kontraktues vendos një kërkesë në dokumentacionin e tenderit, ajo kërkesë bëhet detyruese për të gjithë operatorët ekonomikë.

Ne kemi vepruar në mirëbesim dhe kemi përmbushur këtë obligim.

Operatorët e tjerë nuk e kanë përmbushur.

As operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës (Sfinga Sh.P.K.) nuk ka dorëzuar mostrat e kërkuara, ndonëse të gjithë kanë nënshkruar dhe vulosur Paramasën ku është përcaktuar qartë obligimi: "Para hapjes së ofertave të sillen mostrat e flamujve". Përkundër këtij fakti, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik që nuk ka përmbushur këtë kërkesë, ndërsa kërkesën e dokumentacionit të tenderit e ka injoruar plotësisht gjatë procesit të vlerësimit.

Një veprim i tillë cenon:

- * transparencën;
- * trajtimin e barabartë;
- * proporcionalitetin;
- * sigurinë juridike.

Operatorët ekonomikë nuk mund të detyrohen të përmbushin kërkesa të cilat më pas Autoriteti Kontraktues vendos t'i injorojë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dokumentacionin e tenderit

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur:

- * procesverbal të pranimi të mostrave;
- * evidencë se cilët operatorë kanë dorëzuar mostra;
- * evidencë se cilët operatorë nuk kanë dorëzuar mostra;
- * raport të vlerësimit të mostrave;
- * arsyetim pse kjo kërkesë nuk është marrë në konsideratë.

Nëse kërkesa për mostra nuk kishte efekt juridik, ajo nuk duhej të vendosej fare në dokumentacionin e tenderit.

Nëse kishte efekt juridik, ajo duhej të zbatohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të zgjedhë pas hapjes së ofertave se cilat kërkesa të dokumentacionit do t'i zbatojë dhe cilat jo.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur parimin e pritjeve legjitime

Ne si Operator Ekonomik kemi organizuar përgatitjen, prodhimin dhe dorëzimin e mostrave duke bartur kosto shtesë vetëm sepse Autoriteti Kontraktues e kishte kërkuar këtë.

Më pas Autoriteti Kontraktues deklaroi se kjo kërkesë nuk ka ekzistuar.

Një veprim i tillë cenon rëndë besimin e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues ka bërë verifikimin e mostrave të flamujve pas hapjes së ofertave tek OE e propozuar për kontratë, në vendin ku OE e ushtron veprimtarinë edhe pse në paramasë theksohet qartë që verifikimi në vendin ku OE e ushtron veprimtarinë do të bëhet vetëm për Buqetat me lule ndërsa mostrat e flamujve duhet të sillen para hapjes së ofertave.

Edhe gjatë verifikimit të mostrave të flamujve (të cilat duhet të dorëzoheshin para hapjes së ofertave), AK bën verifikim të mangët (sic shihet në foton e bashkangjitur) pasi ka marrë vetëm 3 mostra të flamujve ndërsa duhet të dorëzoheshin 10 mostra për 10 pozicione të flamujve.

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit sipas procedurës së hapur me kriter Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ne si Operator Ekonomik kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe gjatë përgatitjes së ofertës kemi respektuar të gjitha kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Në dokumentin "**Paramasat për flamuj dhe lule natyrale 2026-2028 pa cmime**", i cili është i bashkangjitur dhe mund edhe të shkarkohet në E-Prokurim dhe i cili është pjesë e dokumentacionit të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka vendosur shprehimisht kërkesën: "**Vërejtje: Para hapjes së ofertave të sillen mostrat e flamujve.**"

Duke u bazuar në këtë kërkesë, ne kemi dorëzuar mostrat para hapjes së ofertave.

Nga informacionet dhe dokumentacioni i procedurës rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka dorëzuar mostrat e kërkuara, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë verifikim, nuk ka përpiluar asnjë procesverbal të vlerësimit të mostrave dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë kërkesë.

Kërkesën për sjelljen e mostrave të flamujve para hapjes së ofertave e gjeni edhe në ofertën (paramasën e cmimeve) të operatorit fitues të nënshkruar dhe vulosur të cilën e kemi bashkangjitur.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës operatorit ekonomik të rekomanduar, pavarësisht shkeljeve të pretenduara në procesin e vlerësimit, na ka shkaktuar dhe kërcënon të na shkaktojë dëme materiale ne si Operator Ekonomik.

Ne kemi marrë pjesë në procedurën e prokurimit duke përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit, duke angazhuar staf, kohë, resurse administrative dhe financiare për përgatitjen e dokumentacionit, kalkulimin e çmimeve, sigurimin e dëshmive dhe dorëzimin e ofertës. Përveç kësaj, duke qenë se në dokumentacionin e procedurës/paramasë ishte paraparë çështja e mostrave, ne kemi bartur edhe kosto shtesë për përgatitjen, sigurimin dhe dorëzimin e mostrave, me qëllim që oferta të jetë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues, me që rast si pasojë edhe e shpenzimeve nga krijimi i mostrave kemi qene jo të barabartë në raport me konkurentët e tjerë.

Me vendimin e kontestuar, ne na është cenuar mundësia reale për fitimin e kontratës publike. Duke qenë se oferta jonë ka qenë pjesë e konkurrencës dhe pretendimet tona lidhen me papërgjegjshmërinë e operatorit të rekomanduar dhe/ose me vlerësimin jo të drejtë e jo të dokumentuar të ofertave, vendimi i AK-së na ka privuar nga mundësia për t'u vlerësuar në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të barabartë. Si pasojë, ne rrezikojmë humbjen e të ardhurave dhe fitimit të pritshëm nga realizimi i kontratës.

Vendimi i AK-së ka krijuar kosto shtesë për ne për ushtrimin e mjeteve juridike, përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim, përgatitjen e ankesës pranë OSHP-së, angazhimin e resurseve profesionale dhe administrative, si dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

Përveç dëmit të drejtpërdrejtë financiar, vendimi i kontestuar cenon edhe pozitën tonë konkurruese në treg, pasi një operator ekonomik që ka respektuar kërkesat e dokumentacionit të tenderit është vendosur në pozitë më të pafavorshme krahasuar me operatorët që, sipas pretendimeve tona, nuk i kanë përmbushur të njëjtat kërkesa ose nuk janë vlerësuar sipas të njëjtit standard.

Për këto arsye, vendimi i Autoritetit Kontraktues jo vetëm që ka shkaktuar shpenzime të panevojshme për ne, por gjithashtu kërcënon të na shkaktojë dëm material përmes humbjes së mundësisë për fitimin dhe realizimin e kontratës publike, humbjes së fitimit të pritshëm dhe shpenzimeve shtesë për mbrojtjen e të drejtave tona në procedurën e shqyrtimit.

Në këtë fazë, ne i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që:

1. Ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar.
2. Ta anulojë Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.
3. Ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin për dhënien e kontratës.
4. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e procedurës në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe kërkesat që vetë i ka publikuar.
5. Të urdhërohet Autoriteti Kontraktues që pranë OSHP-së të paraqesë evidencën zyrtare të pranimit të mostrave, procesverbalin e pranimit dhe çdo dokument tjetër që dëshmon dorëzimin e mostrave nga operatorët ekonomikë. Në mungesë të një evidence të tillë, të konstatohet se kërkesa e dokumentacionit të tenderit nuk është

zbatuar në mënyrë të barabartë dhe se vendimi për dhënien e kontratës është marrë në kundërshtim me dokumentacionin e tenderit.

6. Nëse OSHP vlerëson se procedura nuk mund të korrigjohet për shkak të kundërthënies të krijuara nga vetë Autoriteti Kontraktues, të urdhërojë anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe të beje ritenderimin e tij.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*